



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 693 prot.

Tiranë më 16.04.2021

Lënda: Kërkesë për bllokimin e faqes së internetit www.patronazhisti.com.

AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) është vënë sot në dijeni, nëpërmjet publikimeve në median elektronike, për ekzistencën e faqes së internetit www.patronazhisti.com, në të cilën aksesohen të dhënat personale të shtetasve, nëpërmjet përdorimit të numrit personal të identifikimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se kjo faqe interneti përbën një burim të hapur dhe të paligjshëm informacioni, në të cilin çdokush ka mundësinë e aksesimit të të dhënave të publikuara në të, në kundërshtim të plotë me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të përcaktuara, respektivisht, në nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Kjo përhapje e paligjshme e të dhënave personale mund të shkaktojë pasoja të rënda për jetën private dhe familjare të qytetarëve, pasi, në gjykimin tonë, iu mundëson, ndër të tjera, grupeve kriminale, në vend dhe jashtë tij, akses të drejtpërdrejtë në të dhënat personale të ruajtura në bazën e të dhënave të aksesueshme nga faqja e internetit në fjalë.

Në këtë kuadër, nisur edhe nga volumi jashtëzakonisht i madh i të dhënave personale që përmban kjo bazë të dhënash, vlerësojmë emergjente ndërhyrjen tuaj të shpejtë për parandalimin e përhapjes së mëtejshme të të dhënave personale që gjenden në të.

Për këtë arsye, bazuar në gurmën “b” të pikës 1 dhe pikën 2/1 të nenit 30 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kërkojmë bashkëpunimin dhe reagimin tuaj institucional dhe ligjor në lidhje me si vijon:

- (i) Bllokimin e menjëhershëm, nga ana e AKEP, të faqes së internetit www.patronazhisti.com, si dhe çdo lidhjeje tjetër të aksesueshme përmes saj, apo nga të cilat kjo faqe interneti mund të aksesohet; dhe

- (ii) Ndërmarrjen, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e hapave të nevojshme proceduralë-ligjorë ndaj subjekteve që zotërojnë dhe/ose posedojnë faqen e internetit www.patronazhisti.com.

Lutemi të na informoni në lidhje me hapat e ndërmarra sipas pikave (i) dhe (ii) më sipër.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



